

AKT THEMELIMI
i Shoqërisë "AM&RO" Sh.p.k.

Sot, më datë 06 / 11 /2024,

-Znj. **Martilda Gjuci**, shtetase shqiptare, lindur me 06.06.1987, ne Bruç, mbajtese e dokumentit te identifikimit me nr. personal I75606010L, madhore e me zotesi te plote juridike e per te vepruar;

Në përputhje me Ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar) dhe Ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007, " Për regjistrimin e biznesit ", ka vendosur të themelojë një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar "**AM&RO**" Sh.p.k. (më poshtë referuar si "Shoqëria").

NENI 1

EMËRTIMI

Emri i Shoqërisë është "**AM&RO**" Sh.p.k.

NENI 2

SELIA

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga "Demokracia", Kompleksi "Shirzana", White Palace, Zone Kadastrale 2884, Kati perdhe, Volumi 7, Tirane.

Shoqëria mund të çelë degë dhe/ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë, si dhe të transferojë selinë e shoqërisë në një adresë apo qytet tjetër.

NENI 3

KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, përveç zgjatjes ose prishjes së mëparshme të saj sipas vendimit të Asamblesë së Ortakëve.

NENI 4

OBJEKTI

Shoqëria ka për objekt të veprimtarisë:

- Veprimtari ne fushen e tregtimit te pajisjeve elektrike, elektronike, elektro-shtepiake, kancelari etj;
- Shitja me shumice dhe/ose pakice, edhe nepermjet platformave online, e produkteve joushqimore te cfaredo lloji, ne vecanti e pajisjeve elektrike, elektronike, elektro-shtepiake, kancelari etj;
- Shitja me shumice dhe/ose pakice, edhe nepermjet platformave online, e produkteve joushqimore te cfaredo lloji, ne vecanti e pajisjeve elektrike, elektronike, elektro-shtepiake, kancelari etj;
- Stokimi dhe ruajtja e produkteve jo-ushqimore, ne vecanti e pajisjeve elektrike, elektronike, elektro-shtepiake, kancelari etj;

Shoqëria mund të kryejë gjithashtu të gjitha operacionet tregtare, mbi pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, operacione financiare, industriale, që do të vlerësohen të nevojshme apo të dobishme për realizimin e objektit të shoqërisë si dhe të blejë pjesëmarrje në kapitalin themeltar të shoqërive të tjera që kanë objekt të njëjtë, të ngjashëm apo që lidhet me të vetin. Shoqëria në ushtrimin e aktivitetit të saj, do të marrë të gjitha autorizimet e lejet e nevojshme pranë institucioneve publike shqiptare, dhe do të mbështetet në rregullat dhe normat në fuqi në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së saj të rregullt ekonomike.



NENI 5

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar është i përbërë nga kontributi në të holla i Ortakut themelues në vlerën 1.000.000 Lekë (nje milion) Lekë dhe është i përbërë nga një kuotë.

Kapitali themeltar ndahet si më poshtë:

- **Znj. Martilda Gjuci**, zotëron 1 kuotë, me 100% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 1.000.000 Leke (nje milion) Lekë dhe 1.000.000 Leke (nje milion) Lekë të kapitalit themeltar.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja në para ose në natyrë, sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve të marra më shumicat të parashikuara për ndryshimin e këtij statuti.

NENI 6

ORGANET E SHOQËRISË

Organet e shoqërisë përbëhen nga Asambleja e ortakëve dhe Organi administrativ.

- Asambleja e ortakëve është organi vendimmarrës i shoqërisë e cila vepron në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.
- Organi i vetëm administrativ i shoqërisë është Administratori. Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë.
Znj. Martilda Gjuci, lindur me 06.06.1987, ne Bruç, mbajtese e dokumentit të identifikimit me nr. personal I75606010L, madhore e me zotesi te plote juridike e per te vepruar, zgjidhet si Administrator për një periudhë prej 5 (pesë) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

NENI 7

LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e statutit të shoqërisë, si dhe nga të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

NENI 8

DISPOZITA FINALE

Ky Akt Themelimi hartohet në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën shqipe.

Përmbajtja e Aktit të Themelimit u lexua dhe nënshkrua nga Ortaku themelues i shoqërisë, duke autorizuar **Administratorin Znj. Martilda Gjuci** për të kryer të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) në Tiranë.

ORTAKU THEMELUES
MARTILDA GJUCI

MARTILDA Gjuci 